

Për sigurinë në veri dialogu është zgjidhja më e mirë

"Nuk mund të ketë një zgjidhje të lehtë të imponuar nga jashtë nga ndonjë forcë ushtarake, e sigurisë apo e zbatimit të ligjit. Prandaj dialogu është korniza e duhur për një zgjidhje afatgjatë. Dhe unë mendoj se është në interes të të gjithëve që dialogu të jetë i suksesshëm, për shkak të integritetit të përgjithshëm euroatlantik, pavarësisht a është fjala për Serbinë apo për Kosovën. Është në interes të të dyja vendeve", thotë kundëradmirali Marl C. Montgomery

Agron Bajrami

formime, si e shihni ju atë sot? A është ajo e aftë të kryejë mandatin që i është dhënë me Kushtetutë?

Montgomery: E kam monitoruar Forcën e Sigurisë të Kosovës që dy vjet e gjysmë dhe unë kam qenë shumë i impresionuar me lider-shipin e saj si me ministrin (Agim) Çeku, gjeneralin (Sylejman) Selimi dhe (Kadri) Kastrati, dhe që të tretë kanë bërë një punë madhështore në arritjen e qëllimit të përcaktuar në të katër sferat e misionit të saj. Zhvillimin e oficerëve të saj, lidhshipi i saj i përgjithshëm profesional, janë të gjitha impresive për mua, dhe reflektojnë një profesionalizëm të përgjithshëm në Forcë, që është në përputhje me mandatin kushtetues dhe flet shumë mirë për lider-shipin dhe zyrtarët e lartë të saj.

KD: Ka pritur se kjo Forcë duhet të transformohej edhe më tej, ndoshta jo menjëherë, por në një të ardhme të afërt apo afatmesme, në një ushtri të njohur. Çfarë janë prurit tuaja dhe cili do të ishte qëndrimi i institucionit tuaj ndaj kësaj?

Montgomery: Ne jemi të përkushtuar ndaj mandatit të tanishëm kushtetues të FSK-së. Ne nuk jemi në pozitë për të gjykuar se si do të duket misioni i ardhshëm i FSK-së, kjo do të varet nga vendimi i institucioneve të Kosovës, NATO-s, BE-së dhe të tjerëve. Detyrë e Komandës Evropiane të SHBA-së është për të punuar nëpërmjet ekipit këshillues të NATO-s dhe ekipit këshillues të KFOR-it, nëpërmjet këtyre infrastrukturave institucionale të NATO-s, për ta ndihmuar FSK-në në përmirësimin e nevojshëm/kështu që unë nuk mund të them se çfarë do të jetë e ardhmja e FSK-së. Unë vetëm mund të them se profesionalizmi dhe lider-shipi i deritanishëm janë shumë të mira për çfarë misioni që do të ketë në të ardhmen.

KD: Cila është perspektiva e NATO-s dhe e prezencës së huaj ushtarake në Kosovë? A parashihet se do të ketë një nevojë për një angazhim afatgjatë të misionit të KFOR-it ose të një force të modifikuar paqeruajtëse? Apo prisni që gjatë rrugës të ketë një reduktim deri në minimum të një force të huaj ushtarake?

Montgomery: Kjo padyshim se do të varet nga faktet në terren. Dhe, ju mund të gjykonit po aq mirë sa edhe unë nëse dialogu për sigurinë do të jetë i suksesshëm. Për partneriteti i suksesshëm dhe zgjidhja e suksesshme e shpavës të sigurisë në veri do të rrisin ato vendime. Dhe unë besoj se është në duart e Komandës së NATO-s për të vendosur për këto çështje.

KD: Pavarësisht prej kësaj, ne kemi prani ushtarake amerikane këtu, natyrisht se është pjesë e NATO-s, por - është Ushtria amerikane. Ka një ndjenjë pozitive kundër Shteteve të Bashkuara në përgjithësi, por ndaj Ushtrisë amerikane në veçanti, në mesin e njerëzve, por edhe të institucioneve. Prandaj, dëshira është, të themi kështu, që përfshirja amerikane të vazhdojë madje përtej mandatit të NATO-s në terren. Sa është e mundur shprehja afatgjatë e forcës amerikane në Kosovë? A do të ketë një prani ushtarake amerikane përtej mandatit të KFOR-it?

Montgomery: Të përgjigjem për këtë në dy mënyra. Fillimisht dua të

Foto: Alban Bajrami



them se Shtetet e Bashkuara janë të zotuar në ndihmën dhe zhvillimin e nevojshëm të FSK-së. Dhe ne tani po bëjmë këtë nëpërmjet NATO-s dhe ekipit këshillues të NATO-s dhe KFOR-it. Dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë nëpërmjet bashkëpunimit tonë. (Se dyti) unë do ta vija theksin në mënyrë të veçantë në Programin tonë të Partneritetit Special me Iowan, dhe rolin që do ta luajë në të atë gjatë Garda Kombëtare e Iowas në zhvillimin e këtij vendi. Dhe unë do t'ju jap një shembull: Ne kemi edhe 21 marrëveshje për Partneritet Shtetëror në Evropë. Mesatarja e tyre është prej njëzet vjetësh në të gjitha rastet. Pra të gjitha këto janë zotime prej njëzet vjetësh, dhe të gjitha janë shumë të suksesshme, qoftë ajo me Gardën Kombëtare të Ohios në Beograd, apo me Gardën Kombëtare të Minnesotës në Kroaci. Ato kanë luajtur rol të theksuar në zhvillimin ushtarak të këtyre vendeve.

Unë pres që Garda Kombëtare e Iowas të ketë një rol plotësisht të njëjtë brenda komizës kushtetuese të Kosovës dhe brenda bashkëpunimit të gjerë bilateral SHBA-Kosovë që shkon përmes proceseve të NATO-s. Unë do të them se Iowa promovon më shumë sesa ndihmë ushtarake. Ka një mundësi të tërë për qasjet e Qeverisë, qoftë për bashkëpunimet ndërmjet qyteteve të Iowas dhe atyre të Kosovës, si qyteti i Iowas Johnstone dhe qyteti i Kosovës Peja. Ose si bashkëpunim ndërmjet universiteteve, apo bashkëpunim agrikuturor. Ka mundësi reale në Manrëveshjen prej Partneritetit Shtetëror dhe unë e di se Iowa është e përkushtuar ndaj saj dhe e di se edhe Kosova është e përkushtuar ndaj saj.

KD: Meqë po flisni për këto lloj marrëdhëniesh dhe bashkëpunimit me Kosovën, si e shihni ju ambientin në të cilin është këtu Ushtria amerikane, flus prej jetës e zakonshme dhe ambientin në përgjithësi...

Montgomery: Kjo është vizita ime e dhjetë për dy vjet, dhe unë në mënyrë të vazhdueshme impresionohem për ndjenjën pozitive që ndihmon këtu ndaj Shteteve të Bashkuara, për qasjet pozitive për të ardhmen euroatlantike që Kosova të jetë plotësisht e integruar në sferat sociale, ekonomike dhe të sigurisë evropiane. Dhe vazhdimisht impresionohem me sasinë e punës që është bërë këtu në infrastrukturë. Sa herë që vij shoh rrugë më të mira. E dini, kur për herë të parë kisha shikuar me

makinë në Tiranë, kisha bërë pesë orë, tani shikoj për dy orë e gjysmë. Por, e dini, ju duhet të shikoni sistemin e rrugëve, shikojni rrjetin elektrik, gjithçka po përmirësohet, por do të duhet pak kohë. Shpresojmë se do të joshim investime me ambientin e mirë që ne vazhdimisht po mundohemi të krijojmë së bashku, SHBA-ja, shtetet evropiane dhe kosovarët. Transparenca dhe infrastrukturata ligjore do të çojnë drejt investimeve të mira nga ndërmarrjet e huaja.

KD: Së fundi ka pasur raportime se kanë filluar diskutimet, të nisura nga Franca, me qëllimin e mbijeljes së komponentit të NATO-s këtu, ose që mandati i KFOR-it të transferohej në komandë të BE-së. Çfarë nënkupton kjo? Shumë njerëz kanë konfuzione, sepse ata nuk duan ta shohin NATO-n duke u larguar, së paku ju derisa nuk kanë kryer detyrën.

Montgomery: Unë nuk di se ka pasur diskutime të tilla. Unë ndjek vetëm diskutimet e NATO-s dhe ato janë shumë specifike për përkushtimet për statusin e Gate 2 dhe çfarë duhet të bëjmë për statusin e Gate 3. Unë nuk di se ka pasur këso farë bisedash.

KD: Pra, ju nuk prisni se një gjë e tillë do të ndodhte, të themi, brenda më pak se një viti?

Montgomery: Unë mendoj se Shtetet e Bashkuara të Amerikës u qëndrojnë besnike vizionit dhe strategjisë së tanishme të NATO-s për sukses në Kosovë.

KD: A shihni ndonjë rol të veçantë që Forca e Sigurisë e Kosovës mund të marrë, madje jashtë kufijve të Kosovës, veçanërisht në ndonjë mision të caktuar jashtë vendit? Më duket se ata edhe kanë bërë kurrsë herë nëse mund të kontribuojnë?

Montgomery: Unë mendoj se Forca e Sigurisë e Kosovës tani është përqendruar në katër misionet: çmimin, ndihmë humanitare, kërkim-shpëtim dhe luftimin e zjarreve.

Me sa di unë, tashmë ata kanë qenë në aksione të kërkim-shpëtim gjatë vërshimeve dy herë në Shqipëri. Unë mendoj se në përgjithësi Shtetet e Bashkuara përkrahin qasjet të përballshme rajonale të menaxhimit në kundërpërgjigje ndaj krizave. Kjo do të thotë, për shembull, si në shtetet tona, Garda Kombëtare e Iowas, nëse ka një toradë në Oklahomë, ata shikojnë ofronjë ndihmë për Gardën Kombëtare, dhe ata ofrohen

KOHA DITORE f.2
16.12.2012

Montgomery: "Tani për tani, pyetjet tjera që lidhen me të ardhmen e FSK-së, më shumë janë të lidhura me Kushtetutën dhe me vendimin e ardhshëm që do të merret këtu në Prishtinë, por gjithashtu edhe në Bruksel

me mjete që nuk mund t'i kenë ekipet e tjera të shpëtimit dhe urgjencave.

Pres të shoh, dhe mendoj se ministri Çeku gjatë këtyre tri ditëve ka folur me ministrin Imami nga Shqipëria dhe ministrin maqedonas të Mbrojtjes, për një qasje rajonale. Dhe ne e mbështesim këtë mbasë një kontakt më të gjerë, që përfshijnë të gjitha vendet anëtare dhe monitoruese të Kartës së Adriatikut për zhvillimin e qasjeve rajonale për kundërpërgjigje ndaj krizave dhe fatkeqësive të ngasime kombëtare. Me këtë qasje, është mirë për të gjitha forcat rajonale të sigurisë, forcave policore dhe forcave mjekësore për të lëvizur lehtë dhe pa u vërejtur përtej kufijve për të ofruar ndihmë të nevojshme urgjente ndaj krizave. Dhe për ta bërë këtë, atë që ne e quajmë pa bujë dhe pa u vënë re, ju duhet të keni një planifikim paraprak, dhe të gjitha trajnimet, marrëveshjet dhe të menduarit e parakohshëm. Dhe kjo është çfarë po bën ministri Çeku, dhe ne mendojmë se kjo është një punë shumë e mëngje dhe ne mendojmë se është e arsyeshme për të gjitha llojet e forcave për të pasur një kapacitet rajonal maksimal për kundërpërgjigje rajonale. Me shtuhitë e ashpër të dëborës së shkurtrt të kaluar, FSK-ja demonstroi një aftësi të theksuar për të shpëtuar njerëz të ngusuar dhe të plagosur, dhe gra shtatzëna me qëllim që të kishin kujdes më të mirë shëndetësor. Demonstroi se ka kapacitet të mjaftueshëm që mund të përdoret edhe për vendet e tjera. Dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kohë të tjera, ngjashëm kanë përkrahur Bosnjën dhe Malin e Zi, prandaj ne përkrahim një qasje më rajonale.

KD: A do të thotë se ky shihet si një hap më afër, i mundshëm për anëtarësimin në NATO, ose se paku të përfshirë FSK-në në këto programe? A është e mundshme ta shohim FSK-në më afër NATO-s?

Montgomery: FSK-ja tani, nëpërmjet bashkëpunimit me NATO-n, në përgjithësi po punon drejt standardeve të NATO-s, që është konsistente me qdo forcë rajonale të sigurisë. Ne vazhdojmë ta mbështesim atë duke punuar drejt standardeve të NATO-s, sepse kështu do të ishte më e përgatitura sikur forcat e tjera gjatë një kundërpërgjigje ndaj katastrofave natyrore. Prandaj, në këtë çështje specifike, do të thosha se është mirë.

Tani për tani, pyetjet tjera që lidhen me të ardhmen e FSK-së, më shumë janë të lidhura me Kushtetutën dhe me vendimin e ardhshëm që do të merret këtu në Prishtinë, por gjithashtu edhe në Bruksel.